



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVË	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUČITRIN	
01 Nr. / Br	44 / 20
Nr. i fq. / Br. sh	- 19 -
Data / Datum	27.02.2020
VUÇITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -I- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRISË, MBAJTUR MË 30 JANAR 2020**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar në orën **10:15**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrris:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fitim Halili, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërzhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Hysni Gërguri, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Selim Rrustemi, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari, Shpëtim Zhegrova dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z. Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës -z. Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Në fillim të mbledhjes, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë mbajti një minutë heshtje në nderim të rënies në krye të detyrës të policit të Kosovës Sami Thaqi.

Para fillimit të diskutimit lidhur me rendin e ditës, Nurtene Çerkezi-Gyshinca dha betimin e anëtares së kuvendit, ashtu që mori të drejtat e plota në këtë pozitë.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - theksoi se nuk ka diçka speciale, por është në interes të qytetarëve që kryesuesi i kuvendit z.Nasuf Aliu pasi që u largua nga partia e tij e mëhershme, të deklarohet se cilit subjekt iu është bashkuar apo ka mbetur i pavarur, duke theksuar se është në interes të dihet se kush po udhëheq me kuvendin. Pastaj shtoi se është obligim që si kryesues i kuvendit të deklaroheni për përkatësinë tuaj politike, pasi që jeni në krye të institucionit.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - sqaroi se ai ka dhënë dorëheqje nga pozitat udhëheqëse të partisë dhe jo domosdoshmërisht edhe nga të qenurit anëtar i AKR-së. Por nëse zyra ligjore e parasheh se duhet të deklarohem sot do ta bëjë një gjë të tillë.

**Ilmi Azemi anëtar i kuvendit** - përsëriti kërkesën e tij që kryesuesi të deklarohet se a është në ndonjë subjekt politik apo është i pavarur.

**Xhafer Tahiri kryetar i komunës** - njoftoi se koalicioni qeverisës në Vushtri është stabil dhe i qëndrueshëm dhe se nuk mendon që kryesuesi i kuvendit ka obligim ligjor të deklarohet për përkatësinë e tij politike. Tutje shtoi se ajo që ka ndodhur në bashkimin e tyre në zgjedhjet e kaluara, po rezulton me suksese që qytetarët po i korrin për çdo ditë.

**Bahrije Ademi-Murati, anëtare e kuvendit** - fillimisht e uroi znj. Nurtene Gjyshinca dhe i dëshiroi punë të mbarë dhe po ashtu e falënderoi znj. Fjolla Ujkani për punën e deritashme në asamble, duke i uruar punë të mbarë në Kuvendin e Kosovës. Anëtarja e kuvendit ngriti një shqetësim të mësimdhënësve që janë në zëvendësim në shkollat e komunës tonë ku ka informacione të sakta se gjatë një takimi me drejtorin e arsimit u është kërkuar që t'i mbajnë nga dy orare me të njëjtën pagë, me apo pa vetëdije kjo është shkelje e të drejtave të punëtorit dhe të drejtave elementare të njeriut. Duke ditur shkallen e papunësisë në vendin tonë i kisha propozuar drejtorit të mos bëjë shkelje ligjore dhe të drejtave të njeriut sepse disa nga ata do veprojnë konform dispozitave ligjore lidhur me kërkesën e paligjshme të drejtorit.

**Agron Perçuku, anëtar i kuvendit** - parashtrori një kërkesë nga një banor në fshatin Novolan i cili është dakorduar edhe me kryetarin e fshatit për emërtimin e një rruge të re në këtë fshat, ku kërkojnë që emri i ri i kësaj rruge të jetë “Miradije Ademi Tahiri” e lindur në vitin 1945 dhe ka vdekur në vitin 2019 në ç’ rast vlerësojnë se ka shumë gra që kanë dhënë kontribut të madh në periudha të ndryshme dhe ato duhet të nderohen në mënyra të ndryshme edhe me emërtim të rrugëve. Kontributi i të ndjerës ka qenë në formë të ndryshme, duke filluar nga rritja dhe edukimi i pasardhësve dhe kontributit në periudhën më të vështirë të luftës në vendin tonë ku nga duart e saj shumë familje u ushqyen dhe u mbajtën në strehim. Lokacioni i kësaj rruge që duhet të emërtohet është në degëzimin e rrugës “Ramë Tahiri” prapa rr. “Kajtaž Tahiri”. Kjo kërkesë është dërguar me miratim të kryetarit të fshatit z.Agron Lushakut dhe presin miratim nga ana e anëtarëve të kuvendit.

**Afrim Namani drejtor i DKA-së** - lidhur me shqetësimin që ngriti anëtarja e kuvendit zonja Bahrie rreth dy orareve, dy norma mësimore për disa mësimdhënës, sqaroi se kjo është shumë e përkohshme dhe konkursi është hapur për ato pozita dhe qëllimi deri në atë kohë është që fëmijët të mos mbeten pa mësimdhënës, për këtë çështje konkursi është shpallur, por janë procedurat që duhet respektuar dhe nuk i kemi detyruar, por me marrëveshje të dyanshme vetëm për të mirën e fëmijëve.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së** - sqaroi se sa i përket kërkesës nga ana e banorëve të një lagjeje në fshatin Novolan për emërtimin e asaj rruge, në para dy jave kemi pasur këtë kërkesë nga banorët dhe kryetari i fshatit dhe ne ua kemi kthyer përgjigjen se me aprovimet e udhëzimeve administrative të dhjetorit 2019 ku ministria e mjedisit dhe Agjensioni Kadastral i sqarojnë procedurat se në momentin e emërtimit të një rruge ajo nuk ka të drejtë të ndërrohet për 10 vite, ndërsa sa i përket rrugëve të reja e kemi një listë që është miratuar në vitin 2015 nga kuvendi komunal dhe e kemi për detyrë së pari ta shpenzojmë atë listë pastaj të vazhdojmë me emërtime të reja. Sa i përket kësaj rruge ne e kemi ftuar palën dhe i kemi propozuar një emër nga lista rezervë sipas proceduarave, kurse nuk mund ta emërtojmë rrugën sipas kërkesës nga ana e banorëve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - ngriti një shqetësim rreth një konkursi për mësimdhënës të lëndës së gjeografisë në shkollën “Martirët” në fshatin Reznik me plotësim norme në shkollën në Mihaliq, ku thuhet se publikimi i këtij konkursi ka qenë më 31.12.2019 dhe koha e aplikimit është nga data 1.1.2020 deri më 15.1.2020. Pyetja ime është në cilin vend të Evropës punohet me

Idhe 2 janar? E dyta në takimin përmbyllës që kemi pasur kryetari i komunës ka premtuar se do t'u paguhen pagat jubilarë punëtorëve të arsimit në fundvit dhe një gjë e tillë nuk ka ndodhur, kur e dimë se në gjykata ka mbi një mijë lëndë nga mësimdhënësit sa i përket kësaj çështjeje dhe a ka komuna borxhe, si edhe a është e përgatitur për këtë proces.

**Afrim Namani drejtor për arsim** - Sa i përket çështjes së mësimdhënësit për lëndën e gjeografisë është ashtu siç e ceket ju, mirëpo kur ia kemi dërguar kërkesën gazetës ajo nuk ka punuar në ato data dhe e kemi dërguar shkresën tjetër, mirëpo ju nuk e keni parë atë shkresë në të cilën është krijuar afat i ri. Sa i përket pagave jubilarë lëndët për të gjithë punëtorët e arsimit në Komunën e Vushtrrisë janë përgatitur dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave ku vlera e tyre është 170,000.670 € mirëpo Ministria e Financave nuk i ka ekzekutuar.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se çështja e pagave jubilarë në fushën e arsimit është duke u bërë një barrë shumë e madhe buxhetore për Komunën e Vushtrrisë, ku vlera totale e padive dhe vendimeve të inspektoratit të punës vetëm për komunën tonë duket se kalon vlerën e një milion e gjysmë eurove dhe kjo është e papërballueshme. Në këtë kontekst nëse nuk intervenon Ministria e Financave për të mbuluar këto pagesa që komuna është duke i humbur nëpër gjykata e të cilat në inspektorat janë aprovuar të gjitha, komuna do të pësojë kolaps financiar. Ai vlerësoi se kontrata kolektive në lëmin e arsimit është nënshkruar në kohë fushate, por që ajo më vonë është shndërruar në dokument ligjor që ka prodhuar efekte juridike në aspektin e obligimeve për komunat. Tutje shtoi se komuna ka planifikuar 170,000.00 € për pagat jubilarë në lëmin e arsimit në ç' rast ka dërguar dokumentacionin, por Ministria e Financave nuk i ka lejuar pagesat e tilla. Për më tepër komuna për këto të drejta nga kontrata kolektive është paditur në gjykatë nga ana e arsimtarëve, e që në pjesën dërrmuese këto konteste janë fituar në shkallë të parë nga këta të fundit, por që komuna i ka ankimuar këto vendime në Gjykatën e Apelit, por gjasat reale janë që epilogu në këto konteste të jetë në dëm të komunës. Në fund tha se këtë gjendje ai si kryetar e ka trashëguar nga e kaluara dhe se është tepër i shqetësuar për mundësitë reale të dëmtimit të rëndë të buxhetit të komunës.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - përsëriti se kërkesa për emërtimin e rrugës të cekur më lartë i është adresuar kuvendit, andaj kërkoi që kjo kërkesë të qitet në votim dhe të bëhet pjesë e rendit të ditës për t'u diskutuar dhe marrë një vendim. Ai vlerësoi se askush nuk ka të drejtë të ia mohojë të drejtën e asaj lagjeje dhe familjeje për emërtimin e asaj rruge, andaj propozoi që për këtë çështje të formohet një komision kuvendar.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së** - njoftoi se lista rezervë e rrugëve është aprovuar në kuvend dhe ajo është valide, andaj palët mund të zgjedhin emra prej asaj liste për emërtim të rrugëve të reja.

**Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor** - sqaroi se lista rezervë e rrugëve është aprovuar në kuvend, dhe afati i vlefshmërisë së asaj liste është pesëvjeçar, por këtë çështje zyra ligjore ka dhënë opinion ligjor. Kjo listë nuk mund të ndryshohet për çdo mbledhje të kuvendit, por ndryshimi i saj mund të bëhet vetëm pas kalimit të afatit të cekur më lartë, duke rikrijuar një listë të re e cila do të merrte aprovimin e kuvendit.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - e përkrah propozimin që të themelohet një komision për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, pasi që në këtë relacion kemi mjaft probleme. Ai përsëriti propozimin e tij që fshatin Nedakoc një rrugë të emërtohet me emrin e Zeqir Gubetinit. Ai komision që do të ngritej, do të shqyrtonte të gjitha kërkesat e bëra deri më tani për emërtim të rrugëve.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - kërkoi nga Drejtoria e Urbanizmit, që të bëjë një vlerësim të kuadrit ligjor, por edhe të vendimeve që lidhen me aprovimin e listës së rrugëve në Komunën e



Vushtrisë. Ajo duhet të konstatojë se ka mundësi ligjore që të bëhet ndryshimi i listës rezervë dhe emërtime të reja të rrugëve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - e përkrahi propozimin e anëtarit të kuvendit z.Ali Januzi, sepse komuna nuk duhet të ia lejojë vetit që mos t'i kryejë obligimet ligjore ndaj kërkesave të qytetarëve. Ai tha se ajo listë mund të ndryshohet nga kuvendi nëse ky i fundit ka vullnet politik dhe shtoi se nuk pajtohet me opinionin e zyrës ligjore, pasi ai është i stilit copy-past dhe i njëjti nuk jep alternativë. Andaj propozoi që të futet në rend të ditës propozimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve, mandati i të cilit duhet të jetë i njëjtë me atë të kuvendit.

**Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit** - tha se themelimi i një komisioni për emërtimin e rrugëve bie ndesh me ligjin, dhe kjo nuk do t'i kontribuonte gjetjes së një zgjidhjeje oportune.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - kërkoi nga Drejtoria e Urbanizmit që të hartojë një informatë me shkrim lidhur me skadimin e afatit ligjor të vendimit për aprovimin e listës rezervë. Në këtë kontekst, si qeveri komunale janë të interesuar që të formohet një komision për shqyrtimin e të gjitha kërkesave të parashtruara nga qytetarët për emërtimin e rrugëve të reja. Andaj nëse ka skaduar afati ligjor pesëvjeçar i listës së këtyre rrugëve, atëherë mund të iniciohet procedura e themelimit të këtij komisioni, i cili në tërësi do t'i shqyrtonte kërkesat e qytetarëve dhe të njëjtat do të dërgohen për aprovim në kuvend, dhe kështu do të formohej një listë e re rezervë e rrugëve. Sa i përket emërtimit të rrugëve ekzistuese, ato nuk mund të ndryshohen pasi kjo është ndaluar me udhëzim administrativ dhe çdo vendim për ndryshime të tilla do të ishte i kundërligjshëm.

**Ermal Lahu, anëtar i kuvendit** - tha se tash për tash ekziston lista me emra rezervë, dhe nëse formojmë komision të ri dhe e bëjmë prapë një listë të re të emrave rezervë, atëherë është e pamundshme ta përmbyllim këtë çështje, sepse prapë se prapë do vjen një emër i ri për një rrugë të re, dhe kështu emrat që gjenden në listën rezervë mund të mos jenë të përshtatshëm për palën apo qytetarin që kërkon emërimin e asaj rruge.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit** - pyeti se nëse një emër i një rruge është gabim a ka të drejtë komisioni të ndërhyj në përmirësimin e atij emri.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së** - tha se komisioni ka të drejtë të bëjë korrigjimin e emrave të rrugëve, edhe pse gabime të tilla nuk ka pasi që ka qenë afati i ankesës në komisionin për ankesa dhe këto probleme kanë mundur të adresohen me kohë.

*Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoi këtë:*

#### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 26 dhjetor 2019;
2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrisë;
3. Shqyrtimi i Raportit janar – dhjetor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet;
4. Shqyrtimi i Draft-Kodit komunal të etikës;
5. Shqyrtimi i Draft – Planit të Integritetit 2020 – 2022;
6. Shqyrtimi i Informatës vjetore lidhur me punën e Drejtorisë për Administratë;
7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta për vitin 2019;



8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, Ministrisë së Punëve të Brendshme- Drejtoria Rajonale e Policisë-Mitrovicë;
9. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës dhe
10. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Draft-Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019 – 2022 (**shqyrtimi i dytë**),
  - b). Shqyrtimi i Draft-rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Veprimtarive Afariste-Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi i dytë**);
  - c). Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e destnimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore,
  - ç). Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit lidhur me përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 26 dhjetor 2019

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se në mbledhjen e fundit të kuvendit për vitin 2019, kishte ngritur një shqetësim të punëtorëve teknik të Kompanisë “Wenda” lidhur me pagesën e përvojës së punës, andaj ai kërkoi përgjigje me shkrim se mbi çfarë baze është refuzuar kjo e drejtë dhe këta punëtorë a do t’i marrin mjetet financiare nga e drejta e përvojës së punës. Për këtë ai paraqiti vërejtje së për një gjë të tillë nuk kishte marrë përgjigje.

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 26 dhjetor 2019, me vërejtjen e paraqitur nga ana e anëtarit të kuvendit z. Ymer Haradinaj.*

2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

2. Diskutimi publik fillon nga data 31 janar 2020 dhe zgjat deri më 2 mars 2020.

3. Obligohet Zyra komunale për informim, që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që si hartues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt.

**25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2020.**

### **3. Shqyrtimi i Raportit janar – dhjetor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - në referim të raportit janar – dhjetor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet, shkoqiti disa raste për të cilat ai vlerësoi se janë shqetësuese për qytetarët e Komunës së Vushtrisë. Në këtë aspekt spikati se çështja e suficitit buxhetor sidomos e granteve është shqetësuese për çdo institucion, mirëpo kur ato përsëriten bëhen edhe më shqetësuese. Rasti më tipik është ai i shkuarjes në suficit i 350,000.00 € nga kategoria e pagave në vitin 2018 dhe të 250,000.00 € në vitin 2019 në kodin e pagave dhe mëditjeve dhe kjo përpos që është shqetësuese është edhe degraduese për qytetin e Vushtrisë sepse në periudhën dyvjeçare të kësaj qeverisjeje janë humbur apo janë shkuar në suficit për mbi 600.000.00 €, këtë nëse e kthejmë në shifra të punësimit kemi afër 40 vende të lira të punës në Komunën e Vushtrisë që nuk janë shpallur. Ai bëri të ditur edhe për anëtarët e kuvendit se mjetet nga kategoria e pagave nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera, andaj kjo qeveri ju ka servuar qytetarëve mungesë të vendeve të punës humbje të mjeteve financiare dhe varfëri. Në vend se të shpallen konkurse të rregullta, në kontinuitet janë bërë punësime përmes kontratave mbi veprën, punësime përmes marrëveshjeve me OJQ, duke marrë në punë militantë partiak. Edhe për këtë nuk është kundër, por pyeti se përse nuk po plotësohen vendet e lira të punës që është obligim ligjor, dhe buxheti po shkon dëm. Shqetësimi tjetër është se 600,000.00 € kanë shkuar në suficit nga grantet në kategorinë e investimeve kapitale, ku këto mjete kanë qenë të planifikuara të shpenzohen në vitin 2019, dhe këto projekte janë të kontraktuara, por punët nuk janë kryer, dhe tani do të vimë tek situata që duhet komuna të hyjë në borxhe, ose të mashtrrojë ndonjë operator ekonomik që mos të paguhet, apo duhet të zvogëlohet numri i projekteve që janë aprovuar për vitin 2020 sepse ndryshe nuk do të mund të kemi barazim në kuptimin matematikor. Pastaj shqetësimi i tretë është lidhur me vazhdimësinë e pagesave sepse vetëm nga data 11.12.2019 deri më 15.25.2019, janë lëshuar pagesa dhe transfere në vlerë prej 3,30000.00 €, këtu shprehu shqetësimin e tij sepse shpenzimi me një shpejtësi kaq të madhe lë vend për dyshim dhe menaxhim të dobët të procesimeve të pagesave. Nga kjo del konkluzion se për 11muaj të vitit kalendarik janë shpenzuar afër 2,000.000 €, ndërsa për 14 ditë të muajit dhjetor 2019 janë shpenzuar mjete enorme të buxhetit të komunës prej 3,30000.00 €. Për të gjitha këto ai shprehu brengosjen e thellë dhe kërkoi përgjigje nga kompetentët nëse jo në mbledhje, atëherë adresimi të bëhet me shkrim.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së** - lidhur me suficitin në investimet kapitale tha se është e vërtetë se ai është 559,000.00 €, dhe kjo ka ndodhur për shkak se kemi pasur disa operatorë të papërgjegjshëm siç është rasti me rrugën e fshatit Nedakoc për faktin se edhe pse mjetet kanë qenë të zotuar, operatori nuk i ka kryer punët, gjithashtu në këtë aspekt për shkuarjen në suficit ka ndikuar edhe dështimi i disa tenderëve tjerë. Lidhur me mbulimin e këtyre projekteve ai u zotua se nuk do ketë probleme sepse në vitin 2019 kemi inkasim më të madh sesa në vitin e kaluar në vlerë prej 558,000.00 €, ndërsa lidhur me numrin e pagesave në fundvit që kemi një volum të madh, ceku se kjo është një dukuri që po na përcjellë gati për çdo vit.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - pyeti se operatori ekonomik që ka zhvilluar projektin e rrugës Vushtri-Nedakoc-Pestovë, a ka qenë i përgjegjshëm edhe vitin e kaluar sikurse këtë vit,

pasi me sa di ai edhe vitin e kaluar ky operator ka qenë i papërgjegjshëm dhe ndaj ti nuk është shqiptuar asnjë vërejtje dhe të njëjtit nuk iu është shkëputur kontrata.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së** - tha se vitin e kaluar nuk ka pasur humbje komuna, pagesat janë kryer me kohë, por vitin 2019 operatori nuk i ka kryer punët.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - deklaroi se e gëzon fakti që pasqyrat financiare tregojnë që trendi i rritjes të të hyrave dhe inkasimit të taksës komunale, por edhe tatimit në pronë ka shënuar një rritje të ndjeshme në këtë vit ku kemi mbi 500.000.00 € inkasim të të hyrave vetanake më shumë sesa që kemi pasur në vitin paraprak dhe kjo tregon për një besueshmëri të qytetarëve në organet e administratës komunale, por edhe një kënaqësi të tyre me ofrimin e shërbimeve që marrin, sepse me vet faktin që paguajnë më shumë ose përgjigjën më shumë në pagesa të obligimeve komunale nënkupton që ata po përgjigjen pozitivisht shërbimeve të mira që marrin në komunë dhe duhet thënë që rritja e këtyre të hyrave vetanake, është lajm i mirë e cila është bërë pa asnjë procedurë përmbartimore, që nënkupton se nuk kemi përdor si komunë mekanizma detyrues për inkasimin e këtyre të hyrave, por kjo është bërë si rezultat i rritjes së besimit të qytetarëve ndaj komunës. Në vazhdim vlerësoi se përpos vitit 2017 në cilin janë dhënë shumë leje ndërtimore dhe kemi pasur të hyra në shkallë më të lartë e i cili ka qenë vit zgjedhor, mund të thuhet se pakrahasimisht kemi pasur rritje të të hyrave se scçili vit tjetër dhe kjo tregon për një efikasitet të të gjitha drejtorive, të cilat i falënderoi për punën e bërë, e të cilat kanë tejkaluar planet për sa i takon inkasimit të të hyrave. Gjithashtu ai falënderoi qytetarët për kryerjen e obligimeve ndaj komunës, sepse komuna funksionon në saje të taksave të qytetarëve dhe ato i kthen prapë tek qytetarët në saje të shërbimeve. Shqetësimet lidhur me pagesat në fund të vitit lidhur me investimet kapitale, janë evidente dhe këto janë duke na përcëlluar qe disa vite radhazi, por edhe në vitet e kaluara. Megjithatë Komuna e Vushtrisë në vitin 2019 është komuna me performancën më të mirë tek projekti i USAID-it për qeverisje të mirë dhe transparente, është komuna e parë dhe përfituese e grantit për menaxhimin e mbeturinave dhe ambient të pastër nga Qeveria Gjermane dhe Ministria e Mjedisit, është komuna me përmirësimin më të madh në indeksin e transparencës të KDI-së ku jemi radhitur si komuna e dytë më transparente dhe po ashtu Komuna e Vushtrisë është e vlerësuar nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe projekti DEMOS si komuna me performancën më të mirë në nivel të të gjitha komunave të Kosovës. Të gjitha këto janë rezultate pozitive, të cilave duhet t'i gëzohemi të gjithë. Por megjithatë kemi sfida në menaxhimin e kontratave, për faktin se kemi vërejtje nga auditori, sepse operatorët ekonomik i kemi këta që i kemi sepse shpeshherë nuk jemi të kënaqur me afatet e përfundimit të punëve nga ana e tyre.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se na gëzon fakti që janë rritur të hyrat vetanke të komunës, por nuk kemi një shpërfaqje reale të indeksit të të hyrave sepse të hyrat nga menaxhimi i mbeturinave nuk mund të paraqiten si e hyrë, por ai është shërbim dhe këtu kemi një diskrepancë për arsye se nuk mund të pranohet teza se është indeksi i rritjes prej 500,000.00 € sepse të hyrat për menaxhimin e të hyrave, gjegjësisht mjetet financiare komuna i ka pasur të planifikuara 660,000.00 € për vitin 2018 që të startohet me këtë projekt sepse nuk ka pasur mjete, ndërsa kompanisë "Uniteti" është dashur t'i paguhen mjetet nga ana e komunës. Në fund tha se duhet të kemi menaxhim më të mirë të kontratave në lëmin e menaxhimit të mbeturinave duke u rritur numri i projekt-menaxherëve pasi këtë ligji nuk e ndalon, dhe kështu do kemi rritje të kualitetit të menaxhimit të mbeturinave në përgjithësi.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar raportit, ceku se shpenzimet për investime kapitale i kemi në masën 75 % të buxhetit që i bie që ¼ e buxhetit nuk është shpenzuar nga qeveria komunale. Nëse krahasojmë me vitin 2018 ku indeksi ka qenë mbi 80 %,



për këtë pyeti se cila ka qenë arsyeja e këtij dallimi ku vitin e parë të qeverisjes kemi pasur mbi 80% të shpenzimit të buxhetit në investime kapitale, kurse vitin 2019 vetëm 75 % dhe kështu kemi rënie të investimeve kapitale kur dihet se si është gjendja edhe në qytet, por edhe në fshatra kemi shumë rrugë që kanë nevojë për asfaltim, kemi nevojë për trotuare, pastaj gjendja jo e mirë në menaxhimin e ujërave të zeza, ujësjellësi, ndriçimi dhe është shqetësuese fakti se ¼ e buxhetit në investime kapitale e planifikuar ka mbetur pa u realizuar, për këtë pyeti se qeveria komunale a ka menduar të hartojë një strategji që në vitin 2020 mos të na mbetet ¼ e buxhetit pa u shpenzuar.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së** - sqaroi se këtë vit kemi pasur 1 milion euro më tepër në investime kapitale, dhe se shpenzimet për kapitale i kemi më të mëdha sesa vitin e kaluar dhe përsëriti se papërgjegjësia e disa operatorëve ekonomik ka bërë që të kemi humbje.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se jemi ndër komunat e pakta të Republikës së Kosovës që kemi arritur nivelin e shpenzimit të buxhetit në masën prej 75 %, dhe kësaj kur i shtojmë faktin se viti 2019 ka qenë vit zgjedhor, dhe kjo është për aplaudim që në një vit zgjedhor të shpenzohet buxheti deri në 75 %. Kjo konstaton se partia në pushtet nuk e ka përdorur buxhetin për përfitim të votave. Në anë tjetër kemi pasur vonesa në implementimin e projekteve kapitale siç është ndërtimi i Qendrës së mjekësisë familjare, sepse ky projekt është vonuar për t'u shpallur pasi që janë vonuar procedurat në AKP për kthimin e kësaj toke në pronësi komunale dhe kështu është vonuar fillimi i realizimit të këtij projekti. Tutje njoftoi kuvendin se janë kthyer 6 hektarë tokë në pronësi komunale dhe për herë të parë komuna jonë do të hyjë në histori që i ka kthyer tokë komunës në procesin e privatizimit dhe që nuk ka humbur toka si në të kaluarën. Prona që ndodhet në vendin e quajtur "tek thertorja" i është kthyer komunës e cila ka një sipërfaqe prej 3 hektarësh dhe në këtë lokacion është vendosur të ndërtohet Qendra kryesore e mjekësisë familjare. Në muajin nëntor ka ardhur pëlqimi nga AKP-ja për realizimin e këtij projekti, por që në fakt nga vonesat e shkaktuara nga niveli qendror në këtë projekt janë humbur rreth 60,000.00 €. Pastaj sqaroi se mangësitë në shpenzimin e buxhetit vinë në një masë edhe si pasojë e centralizimit të procedurave të prokurimit nga Autoriteti Qendror i Prokurimit Publik, pasi ata i shpallin procedurat e prokurimit dhe i përzgjedhin operatorët ekonomik dhe kjo shkakton vonesa në këto procedura të cilat më vonë reflektojnë në shpenzimin e buxhetit të komunës. Në këtë kontekst bëri të ditur se janë duke bërë përpjekje që në bashkëpunim me USAID – in të iniciohet procedura që Kuvendi i Kosovës të ndryshojë ligjin aktual të prokurimit publik. Vonesat në alokimin e buxhetit për komunat e Kosovës, janë evidente, pasi siç dihet buxheti për vitin e kaluar është alokuar në muajin mars dhe kjo shkakton shumë probleme në realizimin e projekteve kapitale. Në fund tha se pavarësisht të gjitha këtyre problemeve dhe shkaktimeve të vonesave, si komunë kanë arritur që të shpenzojnë më tepër se 1 milion euro në kategorinë e investimeve kapitale këtë vit, dhe kemi arritur si komunë që të jemi përfitues të granteve në vlerë prej 1 milion eurove, si rezultat i performancës së mirë si komunë.

*Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoi Raportin janar – dhjetor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet.*

#### 4. Shqyrtimi i Draft-Kodit komunal të etikës (shqyrtimi i parë)

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Kodi i Etikës i Komunës së Vushtrrisë.
2. Diskutimi publik fillon nga data 31 janar 2020 dhe zgjat deri më 2 mars 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet komisioni komunale që si hartues i këtij draft-dokumenti, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet komisioni i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2020.
5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Integritetit 2020 – 2022 (shqyrtimi i parë)

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Plani i Integritetit për vitet 2020-2022 i Komunës së Vushtrrisë.
2. Diskutimi publik fillon nga data 31 janar 2020 dhe zgjat deri më 2 mars 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet Grupi Punues për Zhvillimin e Planit të Integritet që si hartues i këtij draft-dokumenti, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet grupi i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2020.
6. Shqyrtimi i Informatës vjetore lidhur me punën e Drejtorisë për Administratë
7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta për vitin 2019

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se përkundrejt faktit që ky komitet ka bërë një punë të mirë, sipas saj, raporti i tij ka qenë i mangët, sepse siç dihet 10% e popullatës bënë pjesë në kategorinë e personave me nevoja të veçanta, andaj në këtë raport mungojë një mori e informatave të rëndësishme dhe shumë të duhura si për anëtarë të kuvendit, por edhe si qytetarë të Komunës së Vushtrrisë. Duke iu referuar raportit ku thuhet se në klasat e rregullta vijojnë mësimin 104 nxënës me nevoja të veçanta, andaj në këtë kontekst shtroi nevojën që studentë që studiojnë në fakultetin e Pedagogjisë dhe Edukimit t'iu mundësohet të bëjnë punë praktike që njëkohësisht t'iu jepet ndihmë mbështetëse atyre nxënësve në klasa normale, atëherë edhe cilësia e mësimin për ata nxënës do të përmirësohej, pasi që dihet që në një klasë mesatarisht mësojnë 27 nxënës, ku një mësuese do ta kishte shumë vështirë të ofrojë mësim të njëjtë për të gjithë nxënësit tjerët në raport me një nxënës me nevoja të veçanta. Andaj sugjeroi që Drejtoria e Arsimit të merret seriozisht me hartimin e planeve individuale për peronat me nevoja të veçanta në klasë të rregullta. Pastaj tek sigurimi i transportit për fëmijët me nevoja të veçanta, ceku se përpos atyre fëmijëve që vijojnë mësimin në klasat e rregullta, kemi edhe një paralele prej 11 nxënësve për këtë pyeti drejtorin e arsimit që ky transport a sigurohet vetëm për atë klasë apo për të gjithë nxënësit. Pastaj lidhur me të cekurat në raport për vitin 2019 është shumë keq që komuna nuk është marrë me hartimin e një plani arkitektural për qasjen e personave me nevoja të veçanta në objektet private, gjithashtu edhe për qasje në rrugë, pasi siç dihet kemi rrugë në Vushtri në të cilat është problem qasja e personave në përgjithësi e lëre më qasja e personave me nevoja të veçanta.

**Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë së Arsimit** - paraqiti sqarime duke u përgjigjur në pyetjet e anëtares së kuvendit, ku njoftoi se sipas legjislacionit, sigurohet transport i veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta në paralelen e ndarë ku me autokombi ata barten nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - e përgëzoi drejtorin e arsimit, për ndarjen e subvencioneve për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta, dhe ceku se një subvencionim i tillë ka ndodhur për herë të parë dhe është marrë model edhe nga komunat tjera të Kosovës.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se puna vullnetare e praktikantëve nëpër shkolla, në Komunën e Prishtinës, ka rezultuar si mjaft e suksesshme dhe apeloj që edhe në komunën tonë të aplikohet një formë e tillë e ndihmës ku do të mundësonte ofrimin e shërbimeve më të mira në arsim dhe lehtësimin e procesit mësimor për personat me nevoja të veçanta.

**Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë së Arsimit** - tha se Drejtoria e Arsimit, është duke bërë përpjekje maksimale për ofrimin dhe akomodimin sa më të mirë të personave me nevoja të veçanta, dhe për këtë kanë angazhuar asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta. Vitin e kaluar janë angazhuar 3 dhe këtë vit ka kërkuar që ky numër të rritet edhe për 3 tjerë. Kjo është realizuar dhe jemi prej komunave të pakta që kemi ndërmarr kësi lloj veprimesh, pastaj këtë vit do të rritet buxheti për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit** - tha se të gjithë prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta kanë konkurruar për ndihmë për sigurimin e transportit dhe komuna iu ka dal në ndihmë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se e gjithë puna e madhe e kryer për këtë kategori të ndjeshme, nga komuna, nuk dëshirojmë që t'i japim pompozitet dhe ta reklamojnë. Në këtë kontekst njoftoi se të gjitha nënave që kanë fëmijë me sindromin down iu është mundësuar nga komuna një udhëtim 7 ditor në bregdetin e Shqipërisë, po ashtu janë duke iu aprovuar kërkesat organizatës Handikos për operimin sa më të mirë të qendrës në Nedakoc.

**Melihate Basholli-Latifi** - tha se puna e z.Isak Hysenit është shembull dhe ftoi strukturat komunale që para së të vendosni për çështjet për peronat me nevoja të veçanta, ta konsultojnë



z.Hysenin. Pastaj ajo ftoi drejtorin e buxhetit që ta vizitojë qendrën e “Handikosit” dhe të shoh nga afër punën e madhe që bëhet atje, dhe apeloj që të rritet buxheti për këtë kategori. Pastaj drejtori i urbanizimit dhe ai i shërbimeve publike duhet të marrin në konsultim gjatë hartimit të planeve infrastrukturore që lidhen me peronat me nevoja të veçanta.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit** - tha se të gjitha së bashku dhe pa dallim duhet të bëjmë sa më shumë që jetë e mundur për kategorinë e peronave me nevoja të veçanta, e cila është ndër kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë sonë.

*Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Raportin Vjetor të Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta për vitin 2019.*

**8.** Shqyrtimi i Propozim–vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, Ministrisë së Punëve të Brendshme- Drejtoria Rajonale e Policisë–Mitrovicë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

**1.** Me këtë vendim jepet në shfrytëzim pa kompensim parcela kadastrale P-70202053-00478-0, ZK-Prelluzhë, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në sipërfaqe prej 301 m<sup>2</sup>.

**2.** Paluajtshmëria e cekur në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin pa kompensim, në afat prej 99 vitesh, Ministrisë të Punëve të Brendshme – Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicë, për ndërtimin e objektit për nevoja të nënstacionit policor në fshatin Prelluzhë.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata e pronës dhe kopja e planit.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**9.** Shqyrtimi i Draft–Rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës (shqyrtimi i parë)

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se për çështjen e kësaj draft-rregulloreje, kishte propozuar që të formohej një komision që do të merrej me hartimin apo përpunimin e saj. Pastaj ajo dha propozimet që sipas saj janë të arsyeshme që të inkorporohen në këtë draft e të cilat ajo deklaroi se me shkrim do t’ia dërgojë Drejtorisë së Arsimit.

**Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë së Arsimit** - tha se në këtë mbledhje ky draft do ta marr aprovimin që të dërgohet në diskutim publik, dhe me këtë ai u pajtua që ky draft ka mjaft lëshime, të cilat duhet të adresohen dhe të njëjtat të inkorporohen në draftin final të saj.

**Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit** - tha se tek neni 10 i kësaj draft-rregulloreje ku thuhet se: studentit me notën mesatare mbi 9 vlerësohet me 30 pikë kemi një gabim teknik pasi që ky paragraf përsëritet edhe më poshtë.

**Melihate Basholli-Latifi** - tha se tek neni 3, lidhur me përkufizimet, të futen edhe shkollat fillore pasi edhe këta nxënës i nënshtrohen garave qoftë në nivel komunal apo ndërkomunal.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Ndarjen e Bursave për Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrrisë.**

**2. Diskutimi publik fillon nga data 31 janar 2020 dhe zgjat deri më 2 mars 2020.**

**3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4. Obligohet Drejtoria e Arsimit që si hartues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2020.**

**10. Të ndryshme.**

**a). Shqyrtimi i Draft-Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019 – 2022 (shqyrtimi i dytë)**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovohet Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar i Komunës së Vushtrrisë 2019-2022.**

**2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Komunën e Vushtrrisë.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.**

**4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar i Komunës së Vushtrrisë 2019-2021.**

**b). Shqyrtimi i Draft-rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste-Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë)**

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - propozoi që në nenin 5 të kësaj draft-rregulloreje të përcaktohet që edhe veprimtaritë afariste nga paragrafi 2 i këtij ne neni të kenë ditë pushimi ditën e diel. Këtu bëjnë pjesë supermarketet dhe vetëshërbimet.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit** - paraqiti vërejtje për siç tha për dërgimin me vonesë të kësaj draft-rregulloreje në kuvend.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se në rrjetet sociale, kësaj draft-rregulloreje i është dhënë një pompozitet i madh. Dhe bëri pyetje për siç tha se deri tash punëtorët në Komunë e Vushtrrisë kanë punuar 7 ditë, kurse me këtë rregullore po mundësohet që ata të punojnë 6 ditë në javë dhe nëse llogaritet që orari i punës është 8 orë e që shprehur në kuptimin aritmetikor  $6 \times 8 = 48$ , kurse ligji i punës i jep secilit punëtor me kontratë të plotë të punës vetëm 40 orë pune në javë. Andaj duhet të shikohet se mos me këtë rregullore po shkelet ndonjë ligj apo akt tjetër nënligjor. Në fund tha se përcaktimi ditë pushimi në sektorin privat, dita e diel është shumë e mirëseardhur.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - tha se kjo rregullore ka për intencë që të përcaktojë një ditë pushimi për punëtorët e sektorit privat, duke bërë përjashtime në sektorët e caktuar. Ky dokument nuk bie në kundërshtim me ligjin e punës. Kjo rregullore ka për synim vendosjen e rregullit në sektorin privat dhe është e mirëpritur nga bizneset dhe qytetarët. Rregullorja në fjalë në mënyrë të përgjithësuar dhe uniforme ka për qëllim përcaktimin e një dite pushim për bizneset dhe punëtorët, ndërsa Ligji i punës i ka dispozitat, të cilat janë në fuqi e të cilat duhet të zbatohen, sepse në rast moszbatimi, atëherë inspektorati i punës do të ndërmarrë masa konform këtij ligji.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - e përkrahi plotësisht këtë draft-rregullore e cila ka për intencë vendosjen e rregullit në qytetin e Vushtrrisë në sektorin privat sa i përket orarit të punës. Tutje shtoi se taksa e paraparë në paragrafin 5 të nenit 7 mendon se duhet të hiqet për shkak se mund të krijojë pabarazi tek bizneset. Në anën tjetër, kjo dispozitë do të mund të krijonte aso lloj situatë kur një operator ekonomik do ta paguante njëherë këtë taksë e mandej ajo do të mund të keqpërdorej edhe në rastet tjera në vazhdimësi.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - tha se rregullimi i situatës i marrjes së lejes kundrejt një takse prej 20 € për vazhdimin e orarit të punës, e përcaktuar me nenin 7, paragrafi 5, ka për qëllim rregullimin e situatave specifike, përndryshe në situata ku kjo do të shkaktonte shqetësim, atëherë kjo nuk do të lejohet nga ana e organeve kompetente. Ai sqaroi se kjo rregull do të jetë uniforme dhe do të vlejë për tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë (në qytet dhe fshatra).

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** - propozoi që tek neni 7 të shtohet një paragraf i ri që bizneset si: kafene, hotelet, motelet dhe restorantet të kenë një ditë pushimi, një të diel, apo ndonjë ditë tjetër të javës, brenda një muaji.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - propozoi që e diela të jetë ditë pushimi për të gjitha ato biznese që operojnë në qendër të qytetit, tek sallat e dasmave të zgjatet orari i punës deri në ora 1:00 pas mesnate, kurse për rastet tjera, ku prishet qetësia publike, pas mbarimit të orarit të punës, të gjobiten për shkëlje të rregullores, varësisht nga shuma që e përcakton inspektori.



**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - tha se gjatë diskutimeve publike ka pasur, bukur shumë propozime që të gjitha bizneset që operojnë në Komunën e Vushtrrisë të dielen ta kenë ditë pushimi, duke përfshirë edhe farmacitë, por është menduar që kjo do të jetë e vështirë të zbatohet në praktikë. Ideja ka qenë që ato biznese që janë të natyrës së nevojës së përditshme dhe urgjente, të caktojnë një ditë pushimi në marrëveshje mes tyre. Andaj kjo ka mbetur kështu, në vullnetin e tyre që me konsensus të caktojnë një ditë pushimi.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se kjo draft-rregullore e cila pritet të aprovohet sot, mos të harrojmë se ka ekzistuar edhe më herët, por e cila nuk ka gjetur zbatim. Andaj shtoi se mos të mendon koalicioni qeverisës se është kah bënë diçka të jashtëzakonshme, pasi që orët e punës dhe orari në sektorin privat është i përcaktuar me Ligjin e punës që disa vite, por kjo sot e kësaj dite nuk ka gjetur zbatim. Pastaj shtoi se tek neni 7 kishte me qenë mirë që të futet një taksë shtesë prej 50 € për zhvillimin e aktivitet pas orarit të punës për ato biznese që organizojnë muzikë live (muzikë të gjallë). Në fund ai vlerësoi se kjo rregullore po bëhet më tepër për pompozitet në facebooc, sepse ideja që kjo rregullore do të zbatohet prej datës 1 shkurt është e pavërtetë sepse dihet që aktet e komunës hyjnë në fuqi 15 ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit Lokal.

**Melihate Basholli-Latifi** - pagesa nuk duhet të jetë e njëjtë për të gjitha llojet e bizneseve, pra biznesi i vogël, i mesëm dhe i madh nuk duhet ta kenë pagesën e njëjtë. Ajo sugjeroi që të punohet vetëm me orar, e jo pas orarit.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - deklaroi se një prej propozimeve që është dhënë më herët e që tani nuk figuron në rregullore, është që veprimtaritë afariste – bizneset që organizojnë muzikë-live, pas orarit të punës duhet të paguajnë një taksë në vlerë në shumën prej 50 € për orë, por kjo nuk mund të zgjatet më shumë sesa ora 03:00 e mëngjesit.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se nëse pas orarit të punës vazhdohet me punë në lokalet ku organizohet muzikë, dhe nëse kjo bëhet duke u lejuar kundrejt pagesës së një takse, atëherë kjo i bie se “ato biznese po e blejnë shqetësimin e qytetarëve me të holla” dhe kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës sepse shqetësimi i qytetarëve nuk blihet me pare.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - vlerësoi se vendosja e kësaj takse prej 50 € nuk e ka qëllimin e inkasimit të mjeteve financiare, por në realitet ka intencën që aktivitetet e tilla të kufizohen sa të jetë e mundur dhe pikërisht për këtë po vendoset kjo taksë-pagesë. Këto vendime do të merren veç e veç, duke i analizuar rrethanat për secilin rast, sepse siç edhe u tha nuk mund të “blihet me para shqetësimi i qytetarëve”.

**Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit** - tha se pagesa prej 50 € tarifë pas orarit të punës për lokalet që organizojnë muzikë live është e lartë dhe kjo vetëm po thuhet ashtu paushall, pa u analizuar fare.

**Miran Halili, drejtor i DEBPZHR**- njoftoi se është e paraparë në këtë draft-rregullore gjoba deri në 1000 euro kush nuk e respekton orarin (që është i përcaktuar orari, varësisht nga bizneset, kurse deri në ora 3:00 pas mesnate përfundon orari).

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit** - tha se nuk duhet lejuar që lokalet që gjenden në qendër të qytetit që punojnë pas orës 24:00, ndërsa për disa lokale që operojnë në viset rurale dhe në periferi mund të zgjatet orari i punës kundruall pagesës së një takse.

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit** – pyeti se cilat nga propozimet që kanë dalë nga diskutimi publik do të përfshihen në këtë draft? Në këtë rrafsh pyeti se cilat nga lojërat e fatit janë ligjore, pasi që ato janë ndaluar me ligj.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - tha se lidhur me përkufizimin e lojërave të fatit bëhet fjalë për lojëra argëtuese siç janë soni pllay station, kjo ka qenë kërkesë e një qytetari se këto

veprimtari a mund të punojnë pas orës 24:00, por përgjigjja ka qenë që nuk ka arsye që ky orar të zgjatet pasi që në këto lojëra marrin pjesë kategori minore të qytetarëve.

**Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor** - tha se është një gabim teknik tek baza ligjore që duhet të përmirësohet.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - tha se tek neni 7 i rregullores duhet të precizohet lartësia e taksës për lokalet që operojnë në qytet dhe fshat, e që propozoi që për lokalet që operojnë në zonat urbane taksa të jetë 20 €, kurse në zonat rurale 10 €, kjo të bëhet për orët shtesë të punës pas përfundimit të orarit. Pastaj lidhur me propozimin që lokalet e natës të paguajnë taksë shtesë prej 50 € për orë shtesë pas përfundimit të orarit, për këtë propozoi që për orë të paguhet taksa 30 €. Ndërsa lidhur me veprimtarinë e kafiterive dhe restoranteve propozoi që ditën e pushimit ta bëjnë me leje të veçantë nga Drejtoria për Ekonomi, ku çdonjëra prej tyre vjen dhe e precizon një ditë që do ta ketë ditë pushimi dhe këtë e proklamoi në derën e lokalit që atë ditë e ka ditë pushimi.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - nuk është mirë që të bëjmë diskriminim fshat – qytet. Zhegrova tha që për kafiteritë është mirë t'ua bëjmë një orar të dielën që të punojnë p.sh. prej orës 12:00- 17:00. Ai kërkoi që propozimet e tij të qiten në votim. Lidhur me lejen që disa lokale në periferi të qytetit që të punojnë ai vlerësoi se ka disa prej këtyre lokaleve në cilat shkaktojnë probleme në orët e vona të qytetit, dhe lejimi i punës së tyre përtej orarit e shton mundësinë që këto probleme të rriten.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - lidhur me propozimin që restorantet (salla të ahengjeve) të punojnë deri në ora 01:00 pas mesnatës, në realitet ky propozim do të jetë vështirë të realizohet në praktikë, pasi që lokalet e tilla do të mund ta keqpërdornin duke punuar vazhdimisht nën arsyetimin se kanë aheng ku kjo do të mund të instalohej si praktikë e shumë lokaleve tjera. Andaj në këtë kontekst, propozimi është që këto lloj bizneseve të punojnë deri në ora 00:00 pas mesnatës, ashtu siç edhe ka qenë mendimi i shumicës së bizneseve gjatë konsultimit publik.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - propozoi që të gjendet një propozim i arsyeshëm për kafeçajtoret se në cilën kategori të bizneseve hyjnë.

**Miran Halili, drejtor i DEBPZHR**- tha se kafeçajtoret nuk hyjnë në kategorinë e bizneseve që të kenë pushim.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** - tha se kjo rregullore po bëhet për bizneset dhe punëtorët, andaj përsëriti se bizneseve në lëmin e hotelerisë t'iu mundësohet që me vet përcaktim të bëjnë një ditë pushimi duke u marrë vesh ata mes tyre. Në të kundërtën është padrejtësi që ju bëhet këtyre bizneseve që t'iu mohohet e drejta e një dite pushimi për ta.

**Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit** - propozoi që kafiteritë të marrin modelin e barnatoreve që të punojnë me kujdestari.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** - tha se në qytetet e mëdha evropiane praktikohet që të ketë kujdestari të supermarketeve, dhe shtoi se përse një gjë e tillë mos të bëhet edhe në komunën tonë pasi që kjo është shumë e nevojshme sepse gjatë tërë javës qytetarët punojnë, ndërsa ditën e diel mund ta zgjedhin si ditë për konsum. Ai propozoi që të analizohet edhe njëherë mirë kjo draft-rregullore dhe të shtyhet për seancën tjetër, ku do të kishim një analizim inkluziv me të gjitha kategoritë e bizneseve në ç'rast do të merrej mendimi i tyre dhe kështu do të votohej një rregullore pa gabime dhe lehtësisht e zbatueshme në praktikë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - tha se me këtë rregullore po tentohet t'ua < hedhet pluhur syve qytetarëve >, pasi që po plasohet me pompozitet tek qytetarët se nga data 1 shkurt dita e diel po bëhet pushim. Kjo gjë nuk është e vërtetë, pasi që një rregullore e tillë ka qenë në

fuqi dhe është edhe tani dhe e diela ka qenë ditë pushimi. Andaj ai apeloj që mos të ngutemi në aprovimin e kësaj rregulloreje, por ta analizojmë mirë edhe me grupet e interesit-bizneset që të kemi një rregullore praktike dhe lehtë të zbatueshme.

**Miran Halili, drejtor i DEBPZHR** - tha se lidhur me aprovimin e kësaj draft-rregulloreje, janë zhvilluar të gjitha procedurat, duke zhvilluar edhe diskutimin publik, dhe shtoi se askush nuk e mohon faktin se një rregullore e tillë ekziston dhe ajo është në fuqi derisa kjo e reja do ta shfuqizojë. Tutje sqaroi se me këtë draft-rregullore orari i punës në lëmin e hotelërisë është përkufizuar që të jetë 07:00-24:00, por përjashtimisht nga kjo në situata të caktuara ky orar mund të zgjatet dhe atë konform një leje të posaçme të aprovuar nga Drejtoria e Ekonomisë e Komunës së Vushtrrisë.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se Loriku kishte të drejtë, sepse edhe marketet, por edhe restorantet duhet punojnë me kujdestari të dielën. Ai propozoi që gjatë muajit të Ramazanit mos të ketë kufizim, por të punojnë deri në syfy. Pastaj ai arsyetoi se këto propozime dhe vetë kjo rregullore po bëhet për lehtësimin e punës së bizneseve dhe qytetarëve, andaj nuk duhet të kemi komplikime të tilla, por ta aprovojme një rregullore e cila nuk do të ketë defekt gjatë zbatimit në praktikë. Tutje ai sqaroi se orari i punës që përfundon në ora 24:00 për disa biznese nuk është i mjaftueshëm, siç është p.sh rasti tek lokalet që organizohen dasma dhe ahengje, andaj në këtë rast propozoi që të kemi zgjatje të këtij orari.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se sa i përket supermarketeve, konsideroi që nuk e sheh të arsyeshme të punohet me kujdestari, pasi që dikush mund të diskriminohet. Pastaj vlerësoi se për kafiteritë, do të mund të bëhej një rregull që të mbetet në vullnetin e tyre që ata ta bëjnë një ditë pushim. Por marr në tërësi ai pandeh që kjo rregullore duhet të aprovohet, pasi është e patjetërsueshme që punëtorëve t'u mundësohet një ditë pushimi (e diela).

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - pasi falënderoi të gjithë anëtarët e kuvendit për kontributin e dhënë për këtë draft-rregullore, kërkoi informatë nga zyrtarët e Sekretarisë së Kuvendit se a është përcjellë në kuvend versionin final i kësaj draft-rregulloreje pas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dala nga diskutimi publik me grupet e bizneseve, pasi që sipas tij nuk është dërguar versionin i duhur me vërejtjet dhe propozimet e bëra nga diskutimi publik ku kishin marrë pjesë: përfaqësuese të salloneve të ondulimit, biznese individuale, përfaqësues të lojërave të fatit më të cilët është biseduar dhe është ardhur deri tek një tekst. Andaj lidhur me këto zhvillime ai kërkoi që të shkohet me një pauzë 1 orë, që të bëhet verifikimi i versionit dhe pastaj të aprovohet. Në këtë raport ai vlerëson se kjo rregullore është e gatshme për aprovim, dhe si e tillë nuk guxon të shtyhet për më vonë, por ceku se krejt çka mbetet është që të ndërmerren masa ndaj zyrtarëve të Sekretarisë së Kuvendit për moskryerje të detyrës. Ai ceku se është njoftuar opinionin publik se nga data 1 shkurt do të hynë në fuqi kjo rregullore dhe e diela do të bëhet ditë pushimi. Pastaj vlerësoi se ai e di se zbatimi i kësaj draft-rregulloreje do të jetë sfidë, dhe shtoi se askush nuk është i pajtimit që t'i dëmtojë bizneset, por vetëm se po kërkohet vënia e rendit sa i përket orarit të punës së bizneseve, në të kundërtën nëse provohet se kjo rregullore ka efekte negative për bizneset, atëherë kjo mund të ndryshohet sërish në kuvend. Në vazhdim shtoi se tek neni 7 i rregullores kemi përkufizime në terma të përgjithshme pasi që ligji për biznes nuk i njeh si kategori të veçanta p.sh qebaptoret, gjellëtoret dhe çajtoret, por këto hynë në rangun e objekteve të hotelërisë dhe për këtë kuvendi nuk mund të nxjerr rregullore që përdoren terma që nuk figurojnë në ligj. Është diskutuar shumë se a duhet lejuar që të punojnë kafiteritë, qebaptoret, çajtoret që në tërësi janë 50 sosh, dhe në këto objekte ne të gjithë ushqehemi dhe krejt e dimë që ato nuk e kanë një ditë pushimi për pastrimin e tyre gjeneral, por zhvillimi i aktivitetit të tyre është toleruar pa pushim deri në ngritjen e tyre si biznes, ngritje të standardit sanitar, sepse nëse



shikohet në kushte sanitare, atëherë shumë prej tyre duhet t'i mbyllim si biznes. Në fund tha se dallimi në taksë sa i përket klubeve të natës dhe disa bizneseve tjera si p.sh restoranteve është bërë për shkak se këto klube fitojnë shumë brenda një nate andaj për atë është bërë dalim në 20 dhe 50 €.

**Miran Halili, drejtor i DEBPZHR** - sqaroi se lidhur me versionin e kësaj draft-rregulloreje të dërguar në kuvend, zyrtarët e Sekretarisë së Kuvendi nuk kanë faj, pasi që heqja e nenit që flet për klubet e natës është hequr nga ana e tij, pasi që siç dihet në referim të ligjit nuk njihen bizneset të përkufizuara si klube të natës. Lidhur me propozimet nga diskutimi publik ai tha se ato inkorporohen pas ndryshimeve nga ana e kuvendit. Në fund ai falënderoi zyrën ligjore dhe sekretarinë e kuvendit për ofrimin e ndihmës në hartimin e kësaj draft-rregulloreje.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se pas pauzës së marrë prej 1 ore, u mendua se teksti do të spastrohet sipas propozimeve të bëra, por vëren se ato nuk janë përfshirë. Ai shkoqiti propozimin i cili nuk është inkorporuar e që kuvendi propozoi që të gjitha veprimtaritë afariste nga neni 5 i kësaj draft-rregulloreje ditën e vikendit (e diela) të jetë ditë pushimi.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - falënderoi të gjitha grupet politike për mbështetjen e dhënë për këtë draft-rregullore e po ashtu falënderim edhe për bizneset e komunës që i kanë dhënë përkrahje kësaj rregulloreje. Lidhur me nenin 19 të rregullores, që flet për hyrjen në fuqi, propozoi ndryshimin që kjo rregullore hynë në fuqi dhe fillon të prodhojë efekt juridik nga data 1 shkurt 2020. Kjo është e drejtë e kuvendit dhe kësisoj duhet të jetë, pasi që nga e diela duhet të fillojë zbatimin i rregullores në fjalë.

**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore** - duke iu referuar Rregullores për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës Nr.01/2017 MAPL është e paraparë që 15 ditë pas protokollimit në Zyrën e Protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe nëse brenda atij afati kjo ministria nuk e bënë vlerësimin e ligjshmërisë, atëherë komuna e publikon në web-faqe zyrtare dhe brenda 7 dite hyn në fuqi dhe këtë procedurë jemi të obliguar ta respektojmë. Në të kundërtën rregullorja aktuale e cila është në fuqi mund të zbatohet deri në hyrjen në fuqi të rregullores së re, e cila e shfuqizon rregulloren e vjetër e në të cilën në disa nene parashihet që dita e diel të jetë ditë pushimi.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se qëllimi themelor është që nga data 1 shkurt të fillojë zbatimin i rregullores, dhe për këtë njoftoi opinionin publik se Drejtorja e inspektimeve ka hartuar planin operativ e cila do të jetë në terren për ta zbatuar rregulloren.

*Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Draft-rregulloren për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste-Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.*

c). Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e destnimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202030-00568-0, me kulturë arë e klasës së 5 (pestë), në sipërfaqe prej 550 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja totale 7952m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Druar, pronë e Gëzim (Rifat) Salihut me vendbanim në fshatin Druar, Komuna Vushtrri.**

2. Qëllimi i lejimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit me destinim Fermë për majmërinë e viçave.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën "b" të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

ç). Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit lidhur me përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Gresa Mulin për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi Arta Imerin për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.01-23/18 i datës 25.1.2018, lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), ashtu që në vend të znj. Rrezarta Krasniqi, nga radhët Lidhjes Demokratike (LDK), emërohet znj. Arta Imeri, nga i njëjti subjekt politik, ndërsa në vend të znj. Fjolla Ujkani emërohet znj. Gresa Muli anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

d). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

**Ermal Lahu, anëtar i kuvendit** - ngriti një shqetësim të banorëve të fshatit Karaçë, pasi në disa nga fshatrat e komunës sonë a është paraparë shtrirja e rrjetit të ujësjellësit, për arsye se sistemi i pompimit të fabrikës së ujit nuk e ka kapacitetin për furnizim me ujë të pijshëm në këto fshatra që ndodhen në një nivel më të lartë gjeografik se sa kapaciteti i saj. Banorët e fshatit Karaçë,

kërkojnë t'u bëhet një zgjidhje alternative e ujit ngase dita ditës fshati po boshatiset për shkak të mungesës së ujit.

**Refik Maloku, drejtor i DSHP-së** - tha se në gjitha fshatrat e komunës do të shtrihet rrejt i ujësjellësit, pavarësisht terrenit gjeografik, në ato fshatra ku uji nuk përcillet me rënie të lirë, do të ndërtohen stacione pompimi apo edhe bazene (rezervuarë) të ujit, ndërsa njëjtë do të veprohet edhe në fshatin Karaçë.


**Mbledhja përfundoi në ora 15:10.**

**Bastri Duraku**



**Procesmbajtës**

**Nasuf Aliu**



**Kryesues i Kuvendit**